



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 348 Prot.

Tiranë, më datë 11 . 07 . 2025

VENDIM

Nr. 309, datë 11.07.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 11.07.2025:

VENDOSI

1. Shtyrjen e Vendimmarrjes për deklarimin Pasuri Kulturore e paluajtshme “Ansambël Arkitektonik Urban” e fshatit Lin dhe miratimin e planit për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e saj e të zonës mbrojtëse, me propozim të **IKTK, me argumentet:**
  - Rishikimin e kufijve me qëllim mbrojtjen sa më efikase të zonës Pasuri Botërore;
  - Përfshirjen e dokumentit “HIA” në planin për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e pasurisë kulturore të paluajtshme e të zonës mbrojtëse;
  - Të vlerësohet mundësia e konsultimit me komunitetin;
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
4. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Joli MITROJORGJI

